

Vendim nr. 65 datë 24.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 24.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: AGIM ELEZI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 517(13-2015-6144), datë 28.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2017-555/55, datë 15.03.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022–1130, datë 27.09.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Agim Elezi dhe shtetasja L.H. kanë qenë palë në një konflikt gjyqësor civil, me objekt pavlefshmërinë e kontratave të shitjes së kuotave të shoqërisë “Amal” sh.p.k., ku kërkuesi ka qenë ortak i vetëm. Ai ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kundër shtetases L.H. etj. për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP), me pretendimin se kjo shtetase ka falsifikuar dokumente dhe, bazuar në to, nëpërmjet mashtrimit, ka vjedhur shoqërinë “Amal” sh.p.k. Në kallëzimin e tij kërkuesi ka referuar se prokuroria duhet të verifikonte një sërë dokumentesh të përdorura nga e kallëzuara L.H. mbi bazën e të cilave ishin dhënë disa vendime gjyqësore, dokumente këto që ishin përdorur edhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit e institucione të tjera.

2. Mbi bazën e materialit kallëzues, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. 1458 të vitit 2014 për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Në përfundim të hetimeve, prokurori, duke vlerësuar se nuk ndodhej para elementeve të kësaj vepre penale dhe as të ndonjë vepre tjetër penale, me vendimin e datës 02.03.2015, ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), për shkak se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Në dispozitivin e këtij vendimi, krahas urdhërimit për njoftimin e tij kallëzuesit, prokurori është shprehur se kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ose te prokurori më i lartë.

3. Sipas nenit 329, pika 1, të KPP-së, në fuqi në atë kohë, kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. Kurse sipas nenit 24, pika 5, të këtij Kodi, po sipas përmbajtjes së tij në atë kohë, prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.

4. Kërkuesi ka pranuar se është njoftuar në datën 12.03.2015 për vendimin e prokurorit të shkallës së parë për pushimin e procedimit penal dhe bazuar në kompetencën e njohur prokurorit më të lartë nga neni 24, pika 5, i KPP-së, ai ka paraqitur ankim në Prokurorinë e Përgjithshme.

5. Me shkresën nr. 1427/5 prot., datë 27.03.2015 të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkuesit i është kthyer përgjigje se nuk ka shkaqe ligjore për shfuqizimin e vendimit të prokurorit të shkallës së parë për pushimin e procedimit penal. Në këtë rast, kërkuesit i është bërë e ditur se nëse vijonte të kishte pretendime ndaj vendimit të

prokurorit të shkallës së parë, ai mund t'i drejtohej me ankim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

6. Ndërkohë, në datën 02.04.2015, bazuar në nenin 329, pika 1, të KPP-së, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me ankim kundër vendimit të pushimit të procedimit penal nr. 1458 të vitit 2014.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 517(13-2015-6144), datë 28.10.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesit, me arsyetimin se ky ankim është paraqitur jashtë afatit të përgjithshëm ligjor 10-ditor. Sipas gjykatës, kërkuesit i është bërë e njohur e drejta e ankimit ndaj vendimit të procedimit penal te prokurori më i lartë ose në gjykatën e shkallës së parë, duke pasur, në këtë mënyrë, mundësinë për të zgjedhur organin ku do të ushtronte të drejtën e ankimit ose të bënte ankim njëkohësisht në të dyja organet e parashikuara nga ligji. Ankimet e vendimit të pushimit të procedimit penal te prokurori më i lartë ose në gjykatë janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe ankimi në gjykatë nuk kushtëzohet nga ankimi te prokurori më i lartë. Gjykata e ka gjetur të pabazuar pretendimin e kërkuesit për qenien në afat të ankimit drejtuar asaj për shkakun se kishte ndjekur shkallën hierarkike të ankimit, duke arsyetuar se neni 329 i KPP-së nuk parashikonte ankimin në gjykatë pas ankimit te prokurori më i lartë. Po ashtu, gjykata ka arsyetuar se përgjigja e prokurorit më të lartë në rastin konkret nuk ishte vendim që, si i tillë, të kundërshtohet në gjykatë, ndërkohë që orientimi i dhënë se mund të ankohej në gjykatë ndaj vendimit të prokurorit të shkallës së parë për pushimin e procedimit penal, nuk rivendoste në afat ankimin në gjykatë të kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

8. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2017-555/55, datë 15.03.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke i gjetur të drejta përfundimet e saj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1130, datë 27.09.2022, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Kolegji Penal ka konstatuar se rekursi përmbante të njëjtat shkaqe me ato të ngritura në ankimin përpara gjykatës së apelit, e cila i kishte shqyrtuar ato duke arsyetuar në mënyrë shteruese. Ai, gjithashtu, ka vlerësuar të drejtë dhe të bazuar në ligj konkluzionin e gjykatave të faktit për paraqitjen jashtë afatit ligjor të ankimit të kërkuesit ndaj vendimit të prokurorit të shkallës

së parë për pushimin e procedimit penal, duke konfirmuar përfundimet e tyre për çështjet ligjore të shtruara në këtë rast.

10. Në datën 26.01.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të saj.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. **Kërkuesi** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 11.1. *Së drejtës së ankimit*, pasi gjykatat e zakonshme kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me ushtrimin e ankimit te Prokurori i Përgjithshëm, duke u shprehur se kërkuesi ka pasur të drejtë të ankohet vetëm në gjykatë. Gjatë kohës që ankimi i ushtruar pranë Prokurorit të Përgjithshëm është marrë në shqyrtim, afatet e ankimit gjyqësor duhet të pezulloheshin. Ushtrimi i së drejtës së ankimit në juridiksionin administrativ, kundër vendimit të pushimit, nuk mund të parashkruajë të drejtën e ankimit në juridiksionin gjyqësor.
- 11.2. *Parimit të paanshmërisë*, pasi trupi gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit, ka dhënë edhe vendimin nr. 00-2022-1053, datë 13.09.2022 për të njëjtën mosmarrëveshje ku kërkuesi është palë, që ka të bëjë me vjedhjen e koncesionit të shoqërisë “Amal” sh.p.k.
- 11.3. *Së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi në një kohë kur duhej ta kalonte atë për shqyrtim në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët ose t’i njoftonte ato për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Duke qenë se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2017 dhe janë tejkaluar të gjitha afatet e gjykimit, njoftimi i palëve ishte i detyrueshëm. Në këtë mënyrë është cenuar edhe parimi i kontradiktoritetit.
- 11.4. *Standardit të arsytimit*, pasi interpretimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me arsyetimin e gjykatave të faktit, bie në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të ankimit dhe me faktin se nga hetimet e mëvonshme për kallëzime të tjera, kanë rezultuar dokumente të falsifikuara.

- 11.5. *Parimit të sigurisë juridike*, në drejtim të besueshmërisë së individit të shteti, pasi kërkuksi merret i pandehur për vepra penale për të cilat nuk ka dyshime të arsyeshme se janë konsumuar.
- 11.6. *Standardit të gjykatës së caktuar me ligj*, i cili, për sa i përket gjykimit që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuksit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Duke analizuar respektimin e këtyre kriterëve në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara, duke provuar interesin e tij në çështjen e parashtruar.

15. Kërkuksi ka plotësuar edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ai i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor

në të tria shkallët e gjyqimit të zakonshëm. Në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkuesi nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione temporis*, Kolegji vëren se kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 26.01.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 27.09.2022. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, në drejtim të besueshmërisë së individit të shteti, me argumentin se ai merret i pandehur për vepra penale për të cilat nuk ka dyshime të arsyeshme se janë konsumuar, si dhe cenimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj, me argumentin se gjykimi që zhvillohet në Gjykatën e Lartë lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta. Në lidhje me këto pretendime, kërkuesi, përveç sa është parashtruar më sipër, nuk ka sjellë asnjë argument në mbështetje të tyre, duke mos arritur t'i ngrejë ato në nivel kushtetues, për rrjedhojë, duke mos arritur të provojë cenimin e të drejtave të tij kushtetuese.

18. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuetit, konkretisht për cenimin e së drejtës së ankimit, asaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës të mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, Kolegji vlerëson se *prima facie* ato bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së ankimit

19. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me ushtrimin e ankimit të Prokurori i Përgjithshëm, duke u shprehur se kërkuesi ka pasur të drejtë të ankohe vetëm në gjykatë. Gjatë kohës që ankimi i ushtruar pranë Prokurorit të Përgjithshëm është marrë në shqyrtim, afatet e ankimit gjyqësor duhet të pezulloheshin. Sipas tij, ushtrimi i së drejtës së ankimit në juridiksionin administrativ, kundër vendimit të pushimit, nuk mund të parashkruajë të drejtën e ankimit në juridiksionin gjyqësor.

20. Neni 43 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtë të ankohe kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Gjykata e ka vlerësuar të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, të lidhur me të drejtën e aksesit, si pjesë të pandara dhe garanci të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të kësaj Gjykate, e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga

një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr.6, datë 26.02.2013; nr.5, datë 02.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit është një e drejtë procedurale, që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “... *nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit*”. Në këtë kuptim, në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit, ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë para së gjithash në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë. Aksesit në gjykatë është një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 6, datë 26.02.2013; nr. 14, datë 26.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata ka pranuar, gjithashtu, se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të sigurisë juridike, si një nga parimet themelore të shtetit të së drejtës. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej apo prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 9, datë 07.02.2017; nr.18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar fakteve që rezultojnë nga dokumentet bashkëlidhur kërkesës, Kolegji konstaton se kërkuuesi e ka kundërshtuar vendimin e prokurorit të shkallës së parë për pushimin e procedimit penal të prokurorit më i lartë (në Prokurorinë e Përgjithshme), mbështetur në nenin 24 të KPP-së në fuqi në atë kohë, ndërkohë që pas marrjes së një përgjigjeje negative për këtë ankim, mbështetur në nenin 329 të KPP-së, po sipas përmbajtjes së tij në atë kohë, ai i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë, e cila ka konstatuar se ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor. Mbi këtë bazë gjykata ka vendosur mospranimin e ankimit, qëndrim i cili është gjetur i drejtë nga gjykatat më të larta.

24. Neni 24 i KPP-së, në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit, ka parashikuar funksionet e prokurorit dhe sipas pikës 4 të tij, urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët, ndërsa Kushtetuta në atë kohë përcaktonte se prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar (neni 148, paragrafi i dytë). Nga ana tjetër, e drejta e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pushimin e çështjes penale parashikohej në nenin 329 të KPP-së në fuqi në atë kohë, sipas të cilit “*kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri*”. Në këtë kuptim, është ligji ai që përcakton rastet dhe mjetet e ankimit, pra që njeh, garanton dhe kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar edhe vendimin e prokurorit të shkallës së parë për pushimin e çështjes penale, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të ndonjë organi tjetër, prokurorit ose gjykatës. Për më tepër, gjykatat e zakonshme, gjatë shqyrtimit të ankimit të kërkuarit, kanë interpretuar edhe përmbajtjen e nenit 329 të KPP-së, interpretim që, në vlerësimin e Kolegjit, nuk cenon standardet kushtetuese të aksesit dhe ankimit, siç do të analizohet në vijim edhe te pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit.

25. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se duke zgjedhur një mjet tjetër ankimi nga ai i parashikuar nga ligji procedural penal për të kundërshtuar vendimin e prokurorit të shkallës së parë për pushimin e çështjes penale, kërkuari ka humbur të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës brenda afatit ligjor.

26. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së ankimit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

27. Kërkuari ka pretenduar se i njëjti trup gjykues i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar rekursin, ka dhënë edhe vendimin nr. 00-2022-1053, datë 13.09.2022, i cili bën fjalë për të njëjtën mosmarrëveshje ku ai është palë, në lidhje me vjedhjen e koncesionit të shoqërisë “Amal” shpk.

27. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shihet

që bëhet (*shih vendimet nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimin nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata ka çmuar se paragjyrimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 46, datë 19.07.2016; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga sa më sipër, parimi i paanshmërisë në gjykim, edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, pra edhe në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues, neni 15, pika 1, i KPP-së parashikon shprehimisht se “*gjyqtari që ka dhënë ose ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit*”.

31. Kolegji, duke iu rikthyer rastit konkret, vëren se në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që ka shqyrtuar çështjen e kërkuesit dhe ka dhënë vendimin e kundërshtuar nr. 00-2022-1130, datë 27.09.2022, kanë marrë pjesë gjyqtarët I.P., S.B. dhe S.S. Të njëjtët gjyqtarë kanë qenë pjesë edhe e trupit gjykues të Kolegjit Penal që ka dhënë vendimin nr. 00-2022-1053, datë 13.09.2022, me të cilin është shqyrtuar rekursi i paraqitur nga kërkuesi kundër vendimeve gjyqësore që nuk kanë pranuar ankimin e tij kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal mbi kallëzimin e paraqitur po prej tij ndaj prokurorëve që kanë dërguar për gjykim një çështje penale kundër kërkuesit. Edhe pse kallëzimet penale të paraqitura nga kërkuesi, për të cilat është vendosur mosfillimi ose pushimi i procedimit penal, kanë marrë shkas nga i njëjti konflikt civil mes kërkuesit dhe shtetas L.H., ato në thelb janë bazuar në shkaqe dhe rrethana të ndryshme. Për rrjedhojë, edhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që kanë shqyrtuar rekursin e paraqitura

nga kërkuesi nuk kanë analizuar të njëjtat rrethana dhe të njëjtat fakte. Në çështjen e përfunduar me vendimin 00-2022-1053, datë 13.09.2022, Kolegji Penal ka vlerësuar shkaqet e rekursit në lidhje me vendimmarrjen e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur nga kërkuesi ndaj prokurorëve të çështjes së tij penale, ndërsa në rastin konkret, shkaqet e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kanë të bëjnë me afatin ligjor për paraqitjen e ankimit prej tij kundër vendimit të prokurorit të shkallës së parë për pushimin e procedimit penal të regjistruar për kallëzimin e tij në adresë të shtetases L.H. etj. Për rrjedhojë, pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarëve në përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk përlligj dyshimin e ngritur nga kërkuesi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

32. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar

33. Sipas kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi në një kohë kur duhej ta kalonte atë për shqyrtim në seancë gjyqësore për të dëgjuar palët ose t'i njoftonte ato për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Në këtë mënyrë është cenuar edhe parimi i kontradiktoritetit.

34. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e rekursit. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes, kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak, vlerësues, është kompetencë vetëm e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Referuar dispozitave procedurale që zbatohen për shqyrtimin e rekurseve nga Gjykata e Lartë, sipas nenit 433 të KPP-së: “1. Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 432 të këtij Kodi. 2. Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit.”. Ndërsa në referencë të nenit 436/a, pika 1, të KPP-së: “Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.”. Në lidhje me rregullat e njoftimit në atë gjykatë, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së: “Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.”.

36. Sipas rrethanave konkrete të çështjes në shqyrtim, vërehet se kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit, në të cilin ka parashtruar shkaqet për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rubrika “Çështje të shpallura për gjykim”, për kategorinë “Çështje penale”, në rubrikën “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, në datën 29.07.2022 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 27.09.2022, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje. Në këtë listë pasqyrohet edhe çështja në fjalë e kërkuesit. Ndërkohë, në datën 23.08.2022 kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë memo, letër ankesë dhe disa dokumente bashkëlidhur. Po ashtu, në datën 21.09.2022 kërkuesi ka paraqitur edhe parashtrës (shih nënparagrafin e fundit të paragrafit 7 të vendimit të Gjykatës së Lartë). Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale të zbatueshme për njoftimin e palëve dhe publikimin e datave të shqyrtimit të çështjeve në atë gjykatë, duke garantuar njëkohësisht edhe të drejtën e kërkuesit për të paraqitur parashtrime në kuadër të realizimit të së drejtës së mbrojtjes.

37. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

D. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

38. Kërkuesi ka pretenduar se interpretimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me arsyetimin e gjykatave të faktit, bie në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të ankimit dhe me faktin se nga hetimet e mëvonshme nga kallëzime të tjera kanë rezultuar dokumente të falsifikuara.

39. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Zbatimi i këtij standardi vlerësohet nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Kolegji, duke verifikuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në rekurs, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Argumentet e pjesës arsyetuese janë të bazuara e të lidhura logjikisht dhe formojnë një përmbajtje koherente. Vendimi nuk rezulton të jetë kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm, apo me kundërthënie ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në pjesën hyrëse të vendimit janë paraqitur rregullisht pretendimet e kërkuarit në rekurs, ndërsa në pjesën arsyetuese Kolegji Penal ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në të nuk i referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432 të KPP-së, si dhe i ka dhënë

përgjigje pretendimit të kërkuarit për mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit nga gjykatat më të ulëta.

42. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

43. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.